



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit

P-019

Prishtinë, më 19 maj 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 19 MAJ 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Xhezair Murati, kurse mungoi Nexhat Daci;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini, dhe Zylfi Merxha, kurse munguan: Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq;

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Kryeministrit : Ramë Manaj;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Ian Perkins dhe Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 maj 2008,
- 2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më \_\_\_ maj 2008**
  - 2.1 Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 16 maj 2008,
  - 2.2 Koha për pyetjet parlamentare,
  - 2.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën,
  - 2.4 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare,
  - 2.5 Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
  - 2.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbarese,
  - 2.7 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit,
  - 2.8 Shqyrtimi i propozimit të grupit të deputetëve për nxjerrjen e Deklaratës kundër shpifjeve të Carla del Ponte.
- 3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave**
  - 3.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007,
  - 3.2 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Ligjit për mineralet dhe të Ligjit për hulumtime gjeologjike,
  - 3.3 Shqyrtimi Raportit për shpenzimet buxhetore të Kuvendit për tre mujorin e parë të vitit 2008,
  - 3.4 Lejimi i udhëtimit zyrtar jashtë vendit të Kryesisë së Kuvendit,
  - 3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Joformal të Grave për lejim e udhëtimit në Mal të Zi,
  - 3.6 Çështja e Qendrës Administrative- Protokollare në Gërmi.

### **4. Të ndryshme.**

- 4.1 Njoftimi me Raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri nga dëgjimi publik me institucionet për siguri.

### **1. Miratimi i procesverbalit i mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 12 maj 2008**

**Sabri Hamit** pati vërejte në procesverbal për pikën 3.7 – Vendimi për lejimin e udhëtimit zyrtar të Komisionit për Integritet Evropian, paragrafi i parë i vendimit duhet të riformulohet, si vijon: “Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacioni të Kuvendit në Bruksel, Belgjikë prej 28 deri më 29 maj 2008”.

Kryesia miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 12 maj 2008 me vërejtjen e cekur më lart.

## **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare se Qeveria ia ka proceduar Kuvendit gjashtë projektligje, që dalin nga Propozimi i Marti Ahtissarit, për shqyrtim dhe miratim, sipas vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, me procedurë të veçantë.

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Qeverisë për procedimin e këtyre projektligjeve, vendosi që seanca plenare të mbahet më 20 maj 2008, me këtë

### **R e n d d i t e**

#### **1. Shqyrtimi i parë i Grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit, sipas procedurës së veçantë:**

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil, dhe
- 1.6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Kryesia vazhdoi me shqyrtimin e përgatitjeve për seancën tjetër të radhës. Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me përgatitjet e nevojshme për seancën tjetër, si dhe kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë, veç e veç.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca tjetër e radhës të mbahet më 30 maj 2008, me këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbaruese,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të buxhetit të Kosovës për vitin 2007,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit,
9. Shqyrtimi i propozimit për nxjerrjen e një deklaratë kundër shpifjeve të Carla del Ponte.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007.

**Kryesia**, vendosi që Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 ta radhisë në rend dite të seancës plenare të 30 majit 2008.

#### **3.2 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Ligjit për mineralet dhe të Ligjit për hulumtime gjeologjike**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me të cilën është pajtuar lidhur me kërkesën e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave për tërheqjen nga procedura e shpalljes së Ligjit për miniera e minerale dhe të Ligjit për hulumtime gjeologjike, me qëllim që këto ligje të rihartohen.

**Kryesia**, pasi e shqyrtoi rekomandimin e Komisionit, nxori këtë

#### **P ë r f u n d i m**

Ngarkohet Zyra Ligjore e Kuvendit që të konsultohet me Zyrën Ligjore të Qeverisë dhe Zyrën Ligjore të UNMIK-ut lidhur me procedurat që duhet të ndiqen për tërheqjen ligjeve, të miratuara nga Kuvendi dhe që i janë dërguar PSSP-së për shpallje, por ende nuk i ka shpallur.

#### **3.3 Shqyrtimi Raportit për shpenzimet buxhetore të Kuvendit përtremujorin e parë të vitit 2008**

**Kryesia** shtyu shqyrtimin e Raportit për shpenzimet buxhetore të Kuvendit për tre mujorin e parë të vitit 2008 për mbledhjen tjetër të radhës, me arsyetimin e se ai duhet të plotësohet **me pjesën tekstuale**.

#### **3.4 Lejimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të delegacioneve të Kuvendit**

**I. Kryesia**, pasi shqyrtoi ftesën e Parlamentit Evropian dhe Asamblesë Nacionale të Sllovenisë dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në takimin që do të mbahet në Bruksel, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, Belgjikë prej 25 deri më 30 maj 2008, i delegacionit të Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit, udhëtimit dhe mëditjet për delegacionin përballohen nga Buxheti i Kuvendit.

**II. Kryesia**, pasi shqyrtoi ftesën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në Sesionin Pranveror, që do të mbahet në Berlin, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Xhavit Haliti, Naim Maloku dhe Slobodan Petrovic- anëtarë të Kryesisë për të marrë pjesë në Sesionin Pranveror të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në Berlin, Gjermani, prej 23 deri më 27 maj 2008.
1. Shpenzimet e qëndrimit dhe të udhëtimit i përballon organizatori, ndërsa mëditjet e plota për delegacionin i përballon Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

**III. Kryesia**, pasi shqyrtoi ftesën e Kryetarit të Parlamentit të Bullgarisë dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në Konferencën për Bashkëpunim Ndërparlamentar të shteteve të Evropës Juglindore, që do të mbahet në Bullgari, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Ibrahim Gashi dhe Hydajet Hyseni, deputetë të Kuvendit dhe Ariana Musliut nga Administrata për të marrë pjesë në Konferencën për Bashkëpunim Ndërparlamentar të shteteve të Evropës Juglindore, që do të mbahet në Sofje, Bullgari, prej 5 deri më 6 qershor 2008.
2. Shpenzimet e qëndrimit, të udhëtimit dhe mëditjet për delegacionin i përballon Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**IV. Xhavit Haliti** propozoi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të jetë nikoqir i takimit të radhës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që do të mbahet vitin e ardhshëm. Kuvendi të jetë nikoqir dhe t'i bëjë ftesë zyrtare Asamblesë Parlamentare të NATO-s që takimin e radhës ta mbajë në Prishtinë.

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Kuvendi duhet t'i bëjë ftesë zyrtare Asamblesë Parlamentare të NATO-s që Seminarin „Rose- Roth“ në vitin e ardhshëm ta mbajë në Kosovë.
2. Kuvendi do ta shtrojë një darkë 100-150 veta për pjesëmarrësit e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, kurse shpenzimet e udhëtimit dhe të vendosjes i bartin vetë delegacionet e vendeve anëtare të saj.

### **1.5 Kërkesë e Grupit Joformal të Grave të Kuvendit të Kosovës për lejim e udhëtimit në Mal të Zi**

**Kryesia** pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Joformal të Grave për lejim e udhëtimit në Kotor të Malit të Zi në Takimin Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Flora Brovina dhe Donika Kadaj- Bujupi për të marrë pjesë në Takimin Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, që mbahet në Kotor, Mal të Zi, prej 29 deri më 31 maj 2008.
2. Shpenzimet e qëndrimit për njëjën pjesëmarrëse i përballon organizatori, kurse për tjetrën i përballon buxheti i Kuvendit.
3. Udhëtimi zyrtar realizohet me veturë dhe vozitës të Kuvendit.

### **3.5 Çështja e Qendrës Administrative - Protokollare në Gërmi.**

**Kryesia** shtyu shqyrtimin e kësaj çështjeje për mbledhjen tjetër të radhës.

## **4. Të ndryshme**

### **3.1 Njoftimi lidhur me Raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri nga dëgjimi publik me institucionet për siguri.**

**Kryesia** u njoftua me Raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri nga dëgjimi publik me institucionet për siguri.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**